



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

V E N D I M

Nr. 31, datë 02/06/2016

PËR

Dhënie ndihme financiare familjes së z.Nikë Palokë Velaj, për djegie banese, në fshatin Mëlgushë, Njësia Administrative Bushat

Këshilli i Bashkisë Vau i Dejës, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile pranë Bashkisë Vau i Dejës lidhur me kërkesën e paraqitur nga **z.Nikë Palokë Velaj, në fshatin Mëlgushë, Njësia Administrative Bushat, Bashkia Vau i Dejës**, ku kërkohet mbeshtetje financiare për të përballuar dëmet e shkaktuara nga djegia e banesës me datë 28.04.2016, bazuar në dokumentacionin e mbajtur (procesverbali i konstatimit të demit dhe procesverbali i PMNZH-së), bazuar në ligjin Nr.139/2015, "Per vetqeverisjen vendore"; Ligjin nr.8756 datë 26.03.2001 "Për emergjenat civile" i ndryshuar; Vendimit të Keshillit të Ministrave nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare, per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore" paragrafi III, pika 1, germa a, b, e Udhezimi i perbashket Ministrise se Brendshme dhe Ministrise se Financave nr.263 date 24.05.2013 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare, per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore"; Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative; Ligji Nr.147/2015 datë 17.12.2015 "Për buxhetin e vitit 2016", në mbledhjen e datës 02/06/2016, me shumicë të cilësuar votash,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare familjes së z. **Nikë Palokë Velaj**, në shumën 10 mijë lekë për të përballuar dëmet e shkaktuara nga djegia e banesës e ndodhur me datë 28.04.2016.
2. Burimi i financimit do të jetë fondi rezervë i cili është planifikuar në buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".
5. U shpall sot me datë 10/06/2016

SEKRETARI
Gentian NDOJ



KRYETARI
Martin MARKU